



LISTA KONTROLLUESE E PUNËDHËNËSIT PËR VETËVLERËSIM

PJESA 2:	RREZIQET NË PUNË
Tema 2.1.	RREZIQET FIZIKE
Nën-tema 2.1.3.	ZHURMA
Ligji / rregulloret përkatëse:	• Ligji Nr.04/L-161/2013 për sigurinë dhe shëndetin në punë; • Rregullore (MPMS) Nr.02/2021 për vlerësimin e riskut në vendin e punës; • Rregullore (MPMS) Nr.02/2017 për mbrojtjen e të punësuarve nga risqet lidhur me zhurmën në vendin e punës; • Rregullores (MPMS) Nr.02/2016 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës.
Shkurtesa:	• MPSM - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
Fushëveprimi i listës kontrolluese:	Kjo listë kontrolli është e zbatueshme në të gjitha industritë dhe sektorët nën fushën e zbatimit të Ligjit Nr.04/L-161, për "Sigurinë dhe Shëndetin në Punë", pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsytet mbi të cilat puna ose trajnimi kryhen në vendet e punës ku ekziston rrezik për shëndetin për shkak të zhurmës.
Përdorimi i listës së kontrollit:	Nëse përgjigjeni "Po" në një pyetje, ju lutemi kaloni në pyetjen tjetër, në rast se përgjigjeni "Jo" bëni vërejtje që mund të ndërmerren veprime për të përmbushur kërkesat ligjore.

Nr.	Pika e kontrollit	Po	Jo	Vërejtje për zbatim
	PARA VIZITËS NË LOKACION / VENDET E PUNËS			
	<i>* Megenëse bëhet fjalë për vetë inspektim, apo vetëvlerësim të situatës në subjektin tuaj nga rreziqet fizike – zhurma, do të ishte mirë që ekipi i inspektimit paraprakisht ta ketë në shqyrtim dokumentin e vlerësimit të riskut, atëherë do të ketë njohuri të afërta me rreziqet dhe masat e përcaktuara, të cilat duhet apo është dashur të ndërmerren nga punëdhënësi për mënjanimin, respektivisht minimizimin e tyre.</i>			
	INSPEKTIMI I LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			

	<i>* Gjatë vizitës në vend punishte / vendin e punës, duhet t'i kushtoni vëmendje të punësuarve që janë të ekspozuar në vende të punës me zhurmë duke i vëzhguar, duke u përgjigjur në pyetjet e përpiluara, duke vëzhguar duke bërë matje dhe duke fotografuar.</i> <i>* Bisedoni me të punësuarit, tregohuni miqësor, shpjegoni dhe këshilloni për të drejtat e tyre sipas legjislacionit.</i>			
	MBIKËQYRJA E LOKACIONIT / VENDEVE TË PUNËS			
1.	A zbatohen rregullat e përcaktuara të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me vlerat kufitare të zhurmës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 4, 1.1 • <i>Së pari merren vlerat kufitare të përcaktuara me këtë rregullore, mandej vërtetohet se a respektohen këto vlera në vendin e punës.</i>			
2.	A ka të punësuar të mitur (nën 18 vjeç) të ekspozuar ndaj zhurmës që tejkalon kufijtë ligjorë? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 4, 1.2 • <i>Së pari ekipi i inspektimit i merr të dhënat nga shërbimi i burimeve njerëzore lidhur me moshën e personave të mitur (nën 18 vjeç) të ekspozuar ndaj zhurmës që tejkalon kufijtë e përcaktuar.</i>			
3.	A i tejkalon mjedisi i punës kërkesat ligjore të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me zhurmën për gratë shtatzëna? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 4, 1.3 • <i>Ekipi i inspektimit i merr të gjitha të dhënat nga shërbimi i burimeve njerëzore lidhur me gratë shtatzëna të ekspozuara ndaj zhurmës që tejkalon kufijtë e përcaktuar dhe vërtetohet se a i tejkalon mjedisi i punës kërkesat ligjore të sigurisë dhe shëndetit në punë në lidhje me zhurmën për gratë shtatzëna.</i>			

4.	A është siguruar vlerësim i përshtatshëm i riskut në lidhje zhurmën në të cilin janë parashikuar masat që duhet të merren? Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 5, 3 dhe neni 16 Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 5, 1 Rregullore (MPMS) Nr.02/2021 • Verifikoni dhe vërtetoni se a janë ndërmarrë masat e përcaktuara nga vlerësimi i riskut, dhe se a i japin ato rezultatet e pritura. • Megjithatë bëhet fjalë për vlerësim të përshtatshëm të riskut, do të duhet të merrni parasysh dispozitat e rregullores për vlerësimin e riskut në vendin e punës.			
5.	A ruhen në formë të përshtatshme të dhënat nga vlerësimi i riskut dhe/ose matja e nivelit të ekspozimit ndaj zhurmës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 5, 4 • Ekipi duhet të vëzhgojë, analizojë dhe vërtetojë se të dhënat nga vlerësimi i riskut dhe/ose matja e nivelit të ekspozimit ndaj zhurmës, ruhen në formë të përshtatshme.			
6.	A kryhen rregullisht matjet dhe vlerësimi i riskut në vendin e punës lidhur me ekspozimin ndaj zhurmës sipas rregullave të përcaktuara? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 6, 1 • Gjithmonë kur bëhet fjalë për matjet dhe vlerësimin e riskut në vendin e punës lidhur me ekspozimin ndaj zhurmës, ato duhet të kryhen rregullisht sipas rregullave të përcaktuara.			
7.	A janë përfshirë vendet e punës nga rreziqet e zhurmës në dokumentin e vlerësimit të riskut? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 6, 4 • Paraprakisht kur pranohet dokumenti i vlerësimit të riskut për vendin e punës, duhet domosdoshmërisht të shikohet se a janë			

	<i>përfshirë edhe vendet e punës nga rreziqet e zhurmës, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.</i>			
8.	A janë ndërmarrë masat konform vlerësimit të riskut? Rregullore (MPMS) Nr.02/201, Neni 6, 5 • <i>Ekipi i inspektimit duhet të konstatojë se a ekziston dokumenti për masat e marra për të përmbushur kërkesat e përcaktuara nga vlerësimi i riskut.</i>			
9.	A ekziston plan tjetër për masat plotësuese? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 7, 3 • <i>Ekipi i inspektimit duhet të konstatojë se a ekziston ndonjë plan i masave teknike dhe/ose organizative nëse vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimi janë rritur ose tejkaluar.</i>			
10.	A janë vendosur shenjat përkatëse? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 7, 4 • <i>Ekipi i inspektimit duhet të konstatojë se a janë shënuar me shenja të përshtatshme vendet e punës, ku ekspozimi ndaj zhurmës arrin ose tejkalon vlerat e veprimit të ekspozimit.</i>			
11.	A është siguruar që në ambientet e çlodhjes për punëmarrësit, ekspozimi ndaj zhurmës të jetë i reduktuar në një nivel në përputhje me qëllimin dhe kushtet e përdorimit të tyre? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 7, 5			
12.	A është ndërmarrë diçka për ekspozimet e rritura të vlerave kufitare? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 8			

	• <i>Ekipi inspektues duhet të konstatojë se a janë siguruar veprime të menjëhershme për të reduktuar ekspozimin nën vlerat kufi të ekspozimit, identifikimi i arsyeve përse ka ndodhur mbi ekspozimi dhe marrja e masave për të parandaluar çdo përsëritje.</i>			
13.	A përdoren mbrojtje të përshtatshme personale të dëgjimit? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 9, 1 • <i>Për rreziqet që krijohen nga ekspozimi ndaj zhurmës që nuk mund të parandalohen me metoda dhe mjete të tjera, dhe kur ekspozimi ndaj zhurmës arrin ose tejkalon vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit, duhet të konstatohet se a posedojnë punëmarrësit mbrojtëse personale të përshtatshme të dëgjimit.</i>			
14.	A është siguruar që mbrojtja e dëgjimit që përdoret nga të punësuarit është e përshtatshme, sipas rregullores (MPMS) Nr.02/2016 - për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse në vendin e punës? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 9, 3 • <i>Duhet të bisedohet me të punësuarit që i përdorin pajisjet e dëgjimit, dhe të pyeten se a janë ato pajisje komode, mos kanë ndonjë shqetësim gjatë përdorimit etj.</i>			
15.	A janë pajisjet personale të mbrojtjes së dëgjimit në përputhje me standardet aktuale evropiane apo ndërkombëtare? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017 Neni 9, 3 • <i>Ekipi inspektues kontrollon këto pajisje lidhur me plotësimin e standardeve përkatëse komfor legjisllacionit.</i>			
16.	A u është dhënë të gjithë të punësuarave të ekspozuar ndaj nivelit të lartë të zhurmës informacion, udhëzime dhe trajnime të			

	përshtatshme dhe të mjaftueshme për mënyrën sesi të mbrojnë shëndetin e tyre? Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 13, 1.3 si dhe Nenet 18 dhe 20 Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 10, 1 • <i>Ekipi i inspektimi duhet t'i qaset evidencave të trajnimeve, e sidomos këtyre të posaçme që janë mbajtur, të zhvillojnë biseda me të punësuarit lidhur me obligimet e punëdhënësit lidhur me informimin dhe me udhëzimet e dhëna.</i>			
17.	A konsultohen me përfaqësuesit e punëmarrësve për vlerësimin e riskut dhe masat e marra, për të eliminuar apo reduktuar ekspozimin ndaj zhurmës? Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 19 Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 11, 1 • <i>Ekipi mund të bisedojë me disa nga të punësuarit, se a janë konsultuar gjatë përcaktimit të masave parandaluese nga vlerësimi i riskut.</i>			
18.	A janë siguruar kontrole të rregullta të dëgjimit për të gjithë punësuarit e ekspozuar ndaj nivelit të lartë të zhurmës? Ligji Nr.04/L-161/2013, Neni 22 Rregullore (MPMS) Nr.02/2017 12, 1 • <i>Ekipi mund të bisedojë me disa nga të punësuarit, se a janë kontrolluar -ekzaminuar për dëgjimin nga institucionet e autorizuara shëndetësore.</i>			
19.	A regjistrohen dhe përditësohen të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore për çdo të punësuar, në përputhje me legjislacionin përkatës për mbikëqyrjen shëndetësore? Rregullore (MPMS) Nr.02/2017, Neni 12, 3			

	• <i>Ekipi i inspektimi duhet t'i qaset evidencave të ekzaminimeve shëndetësore, dhe të verifikojë se a përditësohen me të dhënat e reja për punëmarrësit.</i>			
--	--	--	--	--